



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Agro Invest 1 shpk" të datës 16.06.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "163 Ndërtimi, rregullimi, vendosja dhe pastrimi i lumenjëve dhe kanalizimeve për mbrojtje nga vërshimet- Ri-tender" me nr. të prokurimit 616-25-2547-1-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Agro Invest 1 shpk" të datës 16.06.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "163 Ndërtimi, rregullimi, vendosja dhe pastrimi i lumenjëve dhe kanalizimeve për mbrojtje nga vërshimet- Ri-tender" me nr. të prokurimit 616-25-2547-1-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Agro Invest 1 shpk" (tutje "parashtruesi") me datë 16.06.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "163 Ndërtimi, rregullimi, vendosja dhe pastrimi i lumenjëve dhe kanalizimeve për mbrojtje nga vërshimet- Ri-tender" me nr. të prokurimit 616-25-2547-1-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin merit (in meritum) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

P.1.- "Për eliminimin e kompanisë sonë: Katalogu është në gjuhën gjermane pasi edhe firma që prodhon tubat është gjermane dhe të njëjtin na kanë dhënë fizikisht gjatë vizites tona në zyrat e tyre në Zvicër me datë 26.03.2025, ku edhe janë zotuar për të na furnizuar me tubat dhe elementet e kërkuar me dimensionet dhe karakteristikat e pershkruara në Dosje të këtij projekti. Ne nuk e kemi përthyer katalogun por vetëm disa terma në të cilin pershkruhen të dhënat e tubave. Sa i përket pretendimit të Autoritetit Kontraktues se ky katalog nuk gjendet në faqen zyrtare të firmës Beaver, ju njoftojmë se ëëbsite e tyre është krijuar në vitin 2002 dhe rrjedhimisht katalogu i publikuar aty është i vjetër. Për më tepër edhe katalogu i Operatorit të shpallur fitues nuk është i njëjt me atë të paraqitur në ëëbsite-in e firmës prodhuese. Tek specifikat e tubave në katalog shkruan gjatësia e tubave, konkretisht të rubrika Elementlangen (m) dhe siç shihet gjatësia e tyre është prej 5 deri në 200 metra. Ne kemi prezentuar Certifikatat e leshuara për firmën Beaver Schutzsysteme AG, të leshuara nga Europaverband Hochëasserschutz e.V. (EVH)- Shoqata Evropiane e cila dëshmon për sigurinë në mbrojtje nga permbytjet. Sa i përket vules së raportit të vlerësimit për sistemin mobil, e theksojmë se ne kemi paraqitur raportin origjinal të leshuar nga Ministria e Hungarisë dhe të vulosur, ndërsa përthimi i tij në gjuhën angleze është pa vule sepse atë e kemi përthyer për t'ia lehtësuar juve. Nëse na kërkohet këto dokumente do të përthejmë në gjuhën shqipe nga përthyesi i licencuar".

P.2.- "GOE pretendent për kontratë nuk ka firmosur "MARRËVESHJE DEKLARATE për formimin e grupit 2024" e siç kërkohet me LEGJISLACIONI SEKONAR; 2,000,000.00 Euro., GOE ka paraqitur Deklaratat vjetore të dorëzuara në ATK vetëm për kompaninë ED Construction SHPK, ndërsa për kompaninë IMK - Industria Metalike E Kosovës SH.P.K. është dorëzuar "Gjendja e përgjithshme e deklaramëve dhe transaksioneve të tjera" si dhe për kompaninë lidere nuk ka paraqitur fare Deklarata nga ATK; GOE i propozuar për kontratë ka paraqitur asnjë lloj liste që saktëson titullin e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit si dhe referenca ose certifikata për kryerje e furnizimeve; Kjo kompani nuk është e paraqitur fare në vebfaqen e kompanisë prodhuese: <https://nofloods.com/contact-us/> Gjithashtu deklarata e garancisë e ofruar nga GOE është e datës 21.04.2023 si dhe Certificate of Warranty nuk ka datë, nuk përfaqëson asnjë kompani prodhuese, nuk ka datë lëshimi; Ne paramasë është kërkuar që tubat të jenë fleksibil me diametër 115- 130 cm ndërsa në katalogun e paraqitur nga Operatori i shpallur fitues shihet se tubat janë me diametër prej 140 cm dhe njekohesisht e kalojnë lartësinë e mbajtjes së ujit të kërkuar në dosje - prej 80 cm. Në katalogun e ofruar kjo lartësi është 120 cm, tek tubat 100 dhe 200 m kurse të tubat tjera nuk përmbushet asnjë kriter i kërkuar. Poashtu në katalog nuk pershkruhet materiali i kërkuar në Dosje të tenderit- PE dhe PP dhe koha e mbushjes të tubit me ujë e cila është parapare të jete deri në 5 ore. Grupi i OE të shpallur fitues nuk ka paraqitur Ventilat lidhës: Të standardit 4" Storz 110A për mbushjen dhe shkarkimin e ujit, siç janë kërkuar në Dosje të Tenderit".

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për arsyet si në vijim:

-Kapaciteti teknik dhe profesional kriteri numer tre (3) në FIDT -Katalogu është në gjuhën gjermane dhe nuk përputhet me katalogun në faqen e internetit (website) të prodhuesit ku nuk i plotëson kërkesat e kërkuara.

-Specifikimet teknike të detyrueshme nuk i përmbush kërkesat sipas kriterit të DT-së ku :
Te materialet: përdorë PVC, nuk i përmbush kërkesat e tenderit që kërkojnë materialet PP dhe PE. PVC është i përdorur gjerësisht për barrierat e permbytjeve, por mund të ketë më pak fleksibilitet dhe qëndrueshmëri afatgjatë në kushte ekstreme, krahasuar me PP dhe PE.

-Lidhjet dhe Ventilat: ofron Storz 55, që është një tjetër mangësi e rëndësishme, pasi kërkesa specifike në tender është për STORZ 110A, që ka një diametër më të madh dhe është standardi më i përdorur për sisteme të tilla. Kjo mund të shkaktojë vështirësi për t'u lidhur me pajisje të tjera dhe mund të ndikojë në efikasitetin e sistemit.

-Pikat Mbushëse: Nuk janë dhënë detaje të plota për pikat mbushëse, por është e mundur që pikat të lidhen në mënyrë të centralizuar, siç kërkohet, duke siguruar mbushjen e sistemit me ujë në një pikë të vetme.

-Gjatësia e Seksioneve: ofron seksione vetëm deri në 20 metra,
Në DT kërkohet që seksionet të jenë 100 dhe 200 metra të gjata për shkak të përshtatjeve në terrene të ndryshme, stabilitetit, qëndrueshmërisë ndaj presionit.

-Kapaciteti teknik dhe profesional kriteri numer katër (4) mungon Certifikatës e Konformitetit CE që tregon përputhshmërinë e një produkti me standardet dhe kërkesat e Bashkimit Evropian për siguri, shëndetësi dhe mbrojtje mjedisore.

-Kapaciteti teknik dhe profesional kriteri numer pesë(5) raporti vlerësimi të vlefshëm për sistemin mobil për mbrojtjen nga vërshimet dhe permbytjet nuk është i vulosur.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit sa i përket arsyeve eliminuese të prezantuara në letrën standarde përmes të cilit parashtruesi është eliminuar si i papërgjegjshëm, është gjetur që parashtruesi nuk i konteston fare arsyet për të cilat është eliminuar oferta e tij si e papërgjegjshme me përjashtimin e arsyes së parë eliminuese. Lidhur me arsyen e parë eliminuese vlen të citohet neni 13 par. 4 i LPP ku thuhet se *"Një operator ekonomik mund të paraqesë një tender, një kërkesë për pjesëmarrje apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit të prokurimit, në gjuhën Shqipe, Serbe ose në gjuhën Angleze"*. Rrjedhimisht është gjetur se eliminimi i parashtruesit është bërë në mënyrë të drejtë. Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore lidhur me tenderuesin e rekomanduar është gjetur se përderisa vet parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme, i njëjti nuk mund të trajtohet fare si palë e interesuar në kuptim të nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP. Pavarësisht kësaj është gjetur se oferta e dorëzuar nga tenderuesi i rekomanduar është në përputhje të plotë me të gjitha kërkesat e DT si dhe specifikat teknike të DT duke përfshirë edhe deklaratën për GOE, qarkullimin financiar, listën e kontratave, autorizimet dhe katalogjet. Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën me të drejtë është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore janë të pabazuara në tërësi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 18.06.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.